



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 29 janar 2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_1871 \_ 2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitat e Nenit 9.3 të Kodit të Rrjetit- Dispozitat e përgjithshme,
- Kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Raportit të Derrogimeve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit nr. prot. 2576 të datës 12.12.2023, të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT SH.A),

në seancën e mbajtur me datë 29 janar 2024, nxori këtë:

## V E N D I M

- I. APROVOHET kërkesa e KOSTT SH.A. për shtyrjen/Derrogimin e zbatimit të disa dispozitave ligjore të Kodit të Rrjetit të Transmetimit si në vijim:
  - Dispozitat e Nenit 5.5.4 (Reduktimi nga nënfrekuenca) paragrafi 5.5.4.1 i Kodit Operativ, deri më 31.12.2024.
  - Dispozitat e Nenit 5.8.11 (Testimi i startimit nga errësira), paragrafi 5.8.11.1 i Kodit Operativ, deri më 31.12.2024.
  - Dispozitat e Nenit 8. (Testimet e sistemit) paragrafi 8.4.2 (ndërlidhet me Nenin 5.8.11) të Kodit Operativ, deri më 31.12.2024.

## A r s y e t i m

o Zyra e Rregullatorit për Energji në tekstin e mëtejme ZRRE) me datë 12.12.2023 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A., për derrogim në zbatimin e disa dispozitave nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit. Në kërkesë KOSTT ka kërkuar derrogim të disa dispozitave të Kodit Operativ që është pjesë e Kodit të Rrjetit të Transmetimit:

Dispozitat e Nenit 5.5.4 (Reduktimi nga nënfrekuenca) paragrafi 5.5.4.1,- nuk mund të realizohet në pjesën veriore të vendit deri sa të krijohen kushtet për rehabilitimin e NS Vallaç.



Dispozitat e Nenit 5.8.11 (Testimi i startimit nga errësira), paragrafi 5.8.11.1, nuk mund të realizohet sepse nuk mund të sigurohet puna në "ilotazhë" e njërive gjeneruese të KEK-ut, e poashtu nuk ka marrëveshje me OST tjera për simulim të startimit nga errësira, me çka nënkuptohet se konsumi vendor duhet të mbetet pa furnizim deri të kthehen njësitë gjeneruese vendore në operim normal.

Dispozitat e Nenit 8. (Testimet e sistemit) paragrafi 8.4.2, ndërlidhet me dispozitën 5.8.11 dhe nuk mund të realizohet sepse KOSTT nuk ka marrëveshje me OST tjera për simulim të startimit nga errësira.

- o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës së KOSTT SH.A. me arsyetimet e dhëna në të, ka vlerësuar se kërkesa për derrogim për rrethanat dhe situatën reale, dhe krijimin e kushteve, kërkesa si e tillë është e bazuar, dhe në përputhje me dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet: Raporti i Derrogimeve me afatet e lejuara duhet të publikohet në faqen zyrtare të ZRRE-së dhe i dërgohet:

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Lutfije Dervishi, anëtar

  
Eni Buçaj, anëtar

  
Arta Isufi, anëtar

  
Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KOSTT SH.A, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.